



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.116/2024
Datë: 23 prill 2024

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 24 par 1 pika 1.1, nenit 25 par 7 të Rregullores Nr.15/2022 për Statusin, të Drejtat, Detyrimet, Performancën, Disiplinimin Transferimin, Trajnimet dhe Përfundimin e Marrëdhënies së Punës të Bashkëpunëtorit Profesional, në takimin 325, të mbajtur me datë 23 prill 2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e znj. Kaltrina Sfarça, bashkëpunëtore profesionale, për transfer të përhershëm nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në Gjykatën Themelore Mitrovicë – dega Vushtrri.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 23 prill 2024.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në takimin e datës 27 nëntor 2023, ka marrë vendim KGJK.nr.526/2023 për shpallje të shprehje të interesit për transferimin e përhershëm të Bashkëpunëtorëve Profesional në Gjykatat Themelore/Degë. Për shqyrtim të kërkesave të bashkëpunëtorëve profesional dhe për të vlerësuar plotësimin e kushteve për transfer, Këshilli ka themeluar Komisionin për trajtimin e kërkesave të tilla.

Komisioni, pas analizimit dhe shqyrtimit të kërkesës së znj. Sfarça, ka konstatuar se në gjykatën ku ka kërkuar transferimin bashkëpunëtorja në fjalë, nuk ka vend të lirë. Këshilli, duke u bazuar në konstatimin e Komisionit, vendosi ta refuzoj kërkesën për transfer.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Znj. Kaltrina Sfarça;
- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si dhe
- Arkivit.